



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik “Hira Trade shpk” të datës 12.08.2026 kundër njoftimit mbi vendimin lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “165 Furnizimi dhe montimi i serrave” me nr. të prokurimit 616-26-3555-1-1-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik “Hira Trade shpk” të datës 12.08.2026 kundër njoftimit mbi vendimin lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “165 Furnizimi dhe montimi i serrave” me nr. të prokurimit 616-26-3555-1-1-1.
- II. **AUTORIZOHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit të përcaktuar si në pikën I të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHEN** palët e interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik “Hira Trade shpk” (tutje “parashtruesi”) me datë 12.08.2026 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “165 Furnizimi dhe montimi i serrave” me nr. të prokurimit 616-26-3555-1-1-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet ankimore të parashtruesit:

PRETENDIMI I PARË – DEKLARATA PËR SPECIFIKACIONET TEKNIKE NUK PËRMBAN DATËN

Lidhur me specifikacionet teknike të detyrueshme, është kërkuar që OE të paraqesë deklaratën për specifikacionet teknike të mallrave të ofruara, të cilat duhet të përputhen me Aneksin 1.

Deklarata e dorëzuar nga OE i rekomanduar nuk përmban datën e hartimit/nënshkrimit. Për më tepër, dokumenti deklaron përputhshmëri me specifikacionet e Aneksit 1, ndërsa dokumentet nuk dëshmojnë po ato karakteristika. Poashtu OE ka nënshkruar specifikat në Aneksin 1 por ka ofruar tjer specifika me dokumentit.

PRETENDIMI I 2 – MOSPËRMBUSHJA E KËRKESËS NR. 3 PËR FOLIEN 180 MIC

Operatori ekonomik i rekomandur për kontratë tek kapacitetit tekniko-profesional përcakton se OE duhet të dëshmojë kualitetin e folies plastike për minimum 36 muaj – 180 MIC. Në Aneksin 1 është përcaktuar gjithashtu specifikacioni teknik: “180 MIC diffused (UV+EVA+LD+IR+AF)”.

Nga formulimi i kërkesës duhet të ndahet qartë kërkesa për periudhën minimale 36 muaj nga karakteristika e trashësisë/specifikacionit 180 MIC. Termi “minimum” lidhet me periudhën e kualitetit prej 36 muajsh dhe jo me një autorizim që OE të ofrojë një trashësi tjetër të folies.

Për më tepër, OE i rekomanduar ka nënshkruar dhe vëlosur specifikacionin e Aneksit 1 me 180 MIC. Prandaj dokumentet dëshmuuese duhet të përputhen me këtë deklaram dhe të dëshmojnë pikërisht folien e kërkuar, përfshirë karakteristikat UV+EVA+LD+IR+AF.

PRETENDIMI I 3 – PRO-FATURA NUK ËSHTË DËSHMI E KËRKUAR DHE NUK PËRMBAN TË DHËNA TË MJAFTUESHME

Në lidhje me Kërkesën nr. 3, OE ka dorëzuar një pro-faturë e cila nuk përmban përshkrim të mjaftueshëm të produktit dhe as çmim, ndërsa AK nuk kishte kërkuar pro-faturë apo faturë si dëshmi për këtë kërkesë.

Sipas DT-së, dëshmia e kërkuar lidhet me certifikatat e prodhimit dhe DUD-in doganor, me qëllim që të dëshmohet se kompanitë mund të ofrojnë llojin e kërkuar të folies plastike. Për këtë arsye, pro-fatura e dorëzuar nuk mund të zëvendësojë dokumentet që AK i ka kërkuar shprehimisht si dëshmi.

PRETENDIMI I 4 – DUD-I DOGANOR NUK DËSHMON 180 MIC

DUD-i doganor i dorëzuar nga OE i rekomanduar nuk përmban të dhënat e nevojshme për të dëshmuar trashësinë dhe karakteristikat e kërkuara të folies 180 MIC diffused (UV+EVA+LD+IR+AF).

Nga dokumenti rezulton përshkrim tjetër i mallit, përfshirë përshkrimin “film tjetër polietileni, me trashësi mbi 125 mikrometra”, i cili nuk e dëshmon në mënyrë konkrete se malli i importuar/ofruar ka qenë 180 MIC.

Për më tepër, nga DUD-i nuk identifikohet ndonjë folie apo roll me specifikim 180 MIC që do ta lidhte dokumentin me kërkesën e AK-së. Për këtë arsye, DUD-i nuk e përmbush funksionin e dëshmisë së kërkuar për këtë kriter.

PRETENDIMI I 5 – NË VEND TË CERTIFIKATËS SË PRODHIMIT ËSHTË DORËZUAR TECHNICAL DATA SHEET

Në vend të certifikatës së prodhimit të kërkuar nga AK, OE ka dorëzuar një Technical Data Sheet, të datës 24.04.2021.

Ky dokument nuk është certifikata e prodhimit e kërkuar në DT dhe, dhe nuk përmban 180 MIC diffused (UV+EVA+LD+IR+AF).

Për rrjedhojë, dokumenti i dorëzuar nuk mund të konsiderohet automatikisht si zëvendësim i dëshmisë së kërkuar nga AK, veçanërisht kur ai nuk e dëshmon karakteristikën konkrete 180 MIC sipas kërkesës së DT-së.

PRETENDIMI 6 – FATURA NR. 05/2026 NUK DËSHMON FOLIEN E KËRKUAR

OE ka dorëzuar Faturën nr. 05/2026, me përshkrimin "fojë 200 micron, 5000 kg". Ky përshkrim nuk përputhet me specifikacionin e kërkuar nga AK, i cili kërkon 180 MIC diffused (UV+EVA+LD+IR+AF).

Fatura nuk identifikon në mënyrë të mjaftueshme llojin e folies, nuk paraqet rollat dhe nuk jep karakteristikat teknike UV+EVA+LD+IR+AF. Për më tepër, vetë trashësia e deklaruar 200 micron ndryshon nga 180 MIC e kërkuar.

Për këtë arsye, kjo faturë nuk dëshmon posedimin real të folies sipas specifikimit të DT-së edhe sikur të ishte kerkese për përmbushjen e Kërkesës nr. 3.

PRETENDIMI 7 – MOSPËRPUTHJET NË SQARIMET E DHËNA NGA OE

Gjatë vlerësimit, AK ka kërkuar sqarim lidhur me faktin se DUD-i nuk e dëshmonte trashësinë e folies 180 MIC. Në thelb, AK ka kërkuar që OE të sqarojë dhe të dëshmojë se posedon folien plastike 180 MIC.

Pas kërkesës për sqarim, OE është mbështetur në arsyetime lidhur me mënyrën e paraqitjes së të dhënave në DUD dhe në një deklaratë të prodhuesit. Megjithatë, deklarata e prodhuesit nuk ishte dëshmia e përcaktuar në DT për Kërkesën nr. 3 dhe nuk mund të zëvendësojë automatikisht certifikatën e prodhimit dhe dokumentet tjera të kërkuara.

Për më tepër, kontrata publike lidhet ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe operatorit ekonomik fitues. Për këtë arsye, aftësia dhe përmbushja e kërkesave duhet të dëshmohen nga OE në përputhje me kërkesat e DT-së.

Në këto rrethana, konsiderojmë se sqarimet e dhëna nuk e eliminojnë mospërputhjen fillestare të dokumentacionit.

PRETENDIMI 8 – CERTIFIKATAT ISO TË PAVLEFSHME / TË PAVERIFIKUESHME

Në Dosjen e Tenderit është kërkuar që OE të jetë i certifikuar me ISO 45001:2018, ISO 9001:2015, ISO 14001:2015 dhe ISO PAS 99:2012, ndërsa certifikatat duhet të jenë në fushëveprimtarinë e ndërtimit të serrave dhe aktiviteteve të natyrës së bujqësisë dhe me afat valid.

Nga verifikimi i dokumenteve të dorëzuara rezulton se certifikatat e paraqitura nga OE i rekomanduar paraqesin çështje serioze lidhur me validitetin dhe verifikueshmërinë. Në veçanti, certifikata me nr. 1124001918 rezulton me afat të skaduar në periudhën relevante. Nëse një certifikatë është skaduar dhe nuk është valide në momentin relevant të procedurës, ajo nuk mund të shërbejë si dëshmi për përmbushjen e kërkesës së DT-së për certifikim valid.

Kërkojmë që AK të ndermerr masa ndaj OE i cili ka ofruar certifikatë rreme përmes burimit zyrtar të organit kompetent certifikues dhe të mos konsiderojë të përmbushur kërkesën vetëm mbi bazën e kopjeve të dorëzuara nga OE.

PRETENDIMI -9 – PERSONELI AGRONOM

Në Kërkesën nr. 4 të kapacitetit teknik dhe profesional, AK ka kërkuar që OE të ketë të punësuar ose me kontratë njëvjeçare një agronom bujqësor, të diplomuar në Fakultetin e Bujqësisë, ndërsa si dëshmi është kërkuar diploma e fakultetit.

OE i rekomanduar ka paraqitur kontratë pune për detyra specifike, të nënshkruar më 01.07.2026, ndërsa duhet të verifikohet nëse kohëzgjatja dhe përmbajtja e kësaj kontrate përputhen me kërkesën e qartë për kontratë njëvjeçare.

Po ashtu, nga dokumentacioni i shqyrtuar rezultoi se është paraqitur diplomë Master, ndërsa kërkesa e AK-së është formuluar si diplomë fakulteti.

Kërkojmë gjithashtu verifikimin nëse personi i propozuar është përfshirë në listën e pagave dhe nëse dokumentacioni i tij përmbush të gjitha kërkesat e përcaktuara nga AK.

PRETENDIMI -10 – PARIMET E TRAJTIMIT TË BARABARTË DHE VLERËSIMIT TË PËRGJEGJSHËM

Nëse AK ka kërkuar dokumente specifike dhe ka vlerësuar përmbushjen e tyre për një operator, të njëjtat standarde duhet të aplikohen në mënyrë të barabartë ndaj të gjithë tenderuesve.

Pranimi i dokumenteve që nuk përputhen me kërkesat teknike ose me dëshmitë e përcaktuara në DT, ndërkohë që operatorët e tjerë vlerësohen në mënyrë strikte sipas kërkesave të shpallura, cenon parimet e barazisë, transparencës dhe konkurrencës së ndershme.

Në këtë rast, shqyrtimi duhet të përqendrohet në përputhjen reale të dokumentacionit të OE të rekomanduar me kërkesat e DT-së dhe jo në mundësinë e supozuar për të plotësuar më vonë një kërkesë që nuk është dëshmuar në ofertë.

LIDHJA ME KRITERIN E DHËNIES SË KONTRATËS

Kriteri i dhënies së kontratës është "Tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët". Çmimi më i ulët mund të merret në konsideratë vetëm pasi oferta të jetë konstatuar e përgjegjshme dhe në përputhje me të gjitha kërkesat e DT-së.

HIRA TRADE Sh.P.K. pretendon se oferta e saj është e përgjegjshme dhe se vlerësimi i saj nuk mund të shkëputet nga detyrimi i AK-së për të kontrolluar me të njëjtin standard ofertën e rekomanduar për kontratë.

Për këtë arsye, kërkohet që pas rivlerësimit të dokumentacionit dhe aplikimit korrekt të kërkesave të DT-së, të përcaktohet operatori ekonomik që realisht përmbush të gjitha kërkesat dhe që plotëson kriterin e dhënies së kontratës.

Duke u bazuar në faktet, dokumentet dhe argumentet e paraqitura më lart, HIRA TRADE Sh.P.K. i propozon Autoritetit Kontraktues që:

- Ta aprovojë këtë Kërkesë për Rishqyrtim si të bazuar;
- Ta rishqyrtojë Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues B58 për këtë aktivitet të prokurimit;
- Të bëjë rivlerësim të plotë të ofertës së "Berisha Construction" Sh.P.K., duke marrë në konsideratë të gjitha mospërputhjet e evidentuara;
- Të verifikojë në mënyrë të posaçme Kërkesën nr. 3 për folien 180 MIC diffused (UV+EVA+LD+IR+AF), përfshirë DUD-in, certifikatën e prodhimit, Technical Data Sheet, pro-faturën dhe faturën nr. 05/2026;
- Të marrë për bazë certifikatat ISO, përfshirë certifikatën nr. 1124001918;
- Të mos pranojë përmbushjen e kërkesës për agronomin dhe kohëzgjatjen e angazhimit të tij;

Pretendimet ankimore janë shqyrtuar të gjitha një nga një dhe me këtë rast është gjetur se oferta e tenderuesit të rekomanduar është në përputhje të plotë me të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit dhe njëkohësisht është oferta me çmimin më të lirë duke përmbushur të gjitha kriteret për dhënien e kontratës. Pretendimet lidhur me mospërmbushjen e certifikatave të prodhimit, faturave, DUD, stafin profesional, certifikatat ISO, të gjitha janë pretendime të pabazuara dhe të pasakta.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. nënparagrafin b) lidhur me nenin 62 par. 62.1. nënparagrafin d) të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik. Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 18.08.2026

Visar SHEHU

Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.